**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2108/1 Prot                                                                 Rrëshen më, 10 . 06 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 50 datë 03. 06. 2024**
**PËR**
**"PËRDORIM FOND EMERGJENCA CIVILE", BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 të ministrisë Ekonomisë dhe Financave, "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024", në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, të këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", *relacionin nr. 2975/1 prot, datë 02.10.2023, të Komisionit të verifikimit në terren të dëmeve të shkaktuar nga kanali ujitës Malaj, i ngritur me Urdhër nr. 159, datë 05.07.2023 nga kryetari i bashkisë*, së bashku me projekt-vendimin e kryetari i bashkisë, *shqyrtuar/miratiuar në mbledhjen e datës 29.05.2024, në mbledhjen e komisionit të ekonomisë, financave dhe buxhetit,* pas diskutimeve, në mbledhjen e këshillit bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë përdorimin e fondit emergjencave civile, si vijon;

- T'i akordohet ndihmë financiare familjes së Z. Renis Llesh LOCAJ, mbajtës i kartës identitetit H70930029B, banues në fshatin Malaj, njësia administrative Rrëshen, për dëmet e shkaktuara në pronë, në vlerën prej; **162 000** (*njëqind e gjashtëdhjetë e dymijë*) lekë, *bashkëlidhur, relacionin nr.2975 prot, datë 02.10.2023, Urdhërin nr.159, datë 05.07.2023 & Urdhërin nr. 417, datë 21.11.2023*, të Kryetarit të bashkisë, *pjesë përbërse e këtij vendimi.*

2. Pagesa të kalojë, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**S E K R E T A R** — **Gaspër TOPOLLAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË — BASHKIA MIRDITË

**K R Y E T A R** — **Aleksandër PICAKU**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al    tel dhe fax : (00355) (0) 2162233    www.bashkiamirdite.gov.al

**BASHKIA MIRDITË**

**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

Nr 2108 Prot Datë 27/ 05 /2024

**P/V E N D I M**
**Nr. 60 date 27.05.2024**
***"PËR PËRDORIM FOND EMERGJENCA CIVILE"***

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", në ligjit nr.97/2023, "Per buxhetin e vitit 2024", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit plotesues të MFE nr.1, datë.24.01.2024 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024", VKB nr.50 datë 15.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", relacionin, e komisionit te verefikimit te demeve te ngritur me urdherin nr.159, dt.05.07.2023 nga Kryetari i Bashkise, këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

**V E N D O S I:**

*1.* Të perdorë nga fondi i emergjnencave civile:
-Shumën 162 000(njeqindegjashtedhjeteedymije)lekë, për dhënie ndihme financiare per demet e shkaktuara ne prone( sipas relacionit bashkelidhur), Z. Renis Locaj, NJ.A Rrëshen, fshati Malaj Qender
*2.* Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite.
*3.*Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise .
*4.*Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Gaspër TOPOLLAJ** **Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka
Dr.Juridike, prok, protokoll: B. Deda
Dr. AIKE: F.Vorfi
Dr. ABUPV K.Bica

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

E. Prenga

BASHKIA MIRDITË

2425/1 Prot.

Rrëshen, më 05.07.2023

URDHËR NR 159, DATË 05 / 07 /2023

" MBI NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN NË TERREN TË DEMEVE TE SHKAKTUAR NGA KANALI UJITES MALAJ NE PRONEN E LODOVIK SYZIU NE FSHATIN MALAJ QENDER NJËSIA ADMINISTRATIVE RRESHEN "

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 , "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe të VKM Nr. 329 datë. 16.052012 "Për kriteret dhe proçedurat dhenies së ndihmës shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore ", Kreu III, pika 1, gërma " b ", kërkesën e kryetarit të fshatit Malaj- Qendër, e protokolluar në bashkinë Mirditë me datë 30.06.2023 me nr 2425 prot.

URDHËROJ

1. Të ngrihet komisioni për verifikimin e objektit të kërkesës të përcjellë nga kryeplaku i fshatit Malaj – Qendër, për shtetasin Lodovik Syziu
2. Ngritjen e grupit të punës të përbërë nga anëtarët e poshtëshënuar:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ilir | GJINI | Kryetar | Pergj i Emergjencave Civile |
| Martin | BIBA | anetar | Specialist ne Njësinë Administrative Rrëshen |
| Kejdis | PJETRI | anetar | Ing. EC&K |
| Simon | DODA | anetar | Topograf |
| Edi | PRENGA | anetare | Specialiste ne sektorin ë Bujqesise dhe Kadastres |
| Gjovalin | GJOKA | anetar | kryetar i fshatit Malaj - Qender |

3. Të mbahet akt konstatimi dhe relacion mbi te gjithe problematiken e ndodhur ne terren si dhe pasojat qe kane sjelle demtimin ë tokes bujqesore.
4. Verifikimi në teren të bëhet më datë. ___. ___. 2023
5. Ky urdher hyn në fuqi menjeherë.

KRYETARI

Albert MELYSHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA MIRDITE

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË

Nr.2975/2 Prot

Rrëshen më 02.10.2023

# RELACION

**Drejtuar : Bashkisë Mirditë, Drejtorisë Juridike**

I mbajtur sot më datë 07.09.2023, në zbatim të Urdhërit Nr. 215 datë 08.08.2023 ''mbi ngritjen e komisionit për verifikimin në terren të dëmeve të shkaktuar nga kanali ujitjes Malaj qëndër në pronën e z. Renis Locaj ( Lodovik Syziu) në Malaj Qëndër, njësia administrative Rrëshen'' u konstatua nga komisioni si më poshtë :

1- Kanali ujitës që kalon në pronën e Z. Renis Locaj (Lodovik Syziu) (bankina e kanalit kryesor) rezulton se në gjatësinë prej 80 m linear e në vazhdimësi, duke kaluar edhe përtej pronës së tij kishte prezencë të mbetjeve të ndryshme ( shkurre, ferra dhe rrjetë teli) të cilët kanë penguar rrjedhjen e ujit në mënyrë normale, ku si pasojë e kësaj është bllokuar rrjedha e ujit dhe ka kaluar në pronën e Z. Renis Locaj (Lodovik Syziu).

2- Gjithashtu u konstatua si rezultat i mospastrimit në mënyrë periodike si dhe mos hapjes së prizave shkarkuese, për rrjedhojë kanali është tejmbushur dhe ka kaluar uji në pronën e Z.Renis Locaj (Lodovik Syziu).

3- Z. Renis Llesh Locaj për këtë parcele është pajisur me çertefikatë pronësie nr.1681031 e cila ndodhet në fshatin Malaj Qender, ZK 2552 nr. Pasurise 85/3 volum 3 faqe 112, me siperfaqe totale prej 950 $m^2$

4- Dalja e ujit nga kanali dhe prezenca e ujit ka sjellë rrëshqitje të tokës në dy plane rrëshqitje me thellësi mesatarisht 80 - 120 cm dhe me një gjatësi 32 m linear me një sasi prej 450 $m^2$ tokë bujqësore.

5- Duke parë faktikisht gjendjen e strukturës së tokës në këtë parcelë edhe sipërfaqia tjetër prej 500 $m^2$ është e pashfrytëzueshme si tokë bujqësore, pra del që gjithë sipërfaqja e tokës prej 950 $m^2$ të jetë joproduktive .

6 - Mbështetur në VKM nr.89 datë.03.02.2016 '' Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërise '' ,fshati Malaj ka cmimin e referencës 150 lek/$m^2$ , për tokën bujqësore.

## TABELA E VLERSIMIT TË TOKËS DHE FRUTI KULTURËS

| NR. | EMERTIMI | NJESIA | SASIA | ÇMIMI | VLERA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Tokë bujqësore | $M^2$ | 950 | 150 Lek/ m2 | 142500 Lek |
| 2. | Arra 1-5-vjet | copë | 2 | 1000 | 2000 lek |
| 3. | Arra 6-10 vjet | cope | 2 | 4500 | 9000 lek |
| 4. | Fik | copë | 1 | 500 | 500 lek |
| 5. | Kumbulla 1-5 vjet | copë | 2 | 500 | 1000lek |
| 6. | Kumbulla 6-10 vjet | copë | 2 | 2500 | 5000 lek |
| 7. | Lajthi | copë | 2 | 500 | 1000 lek |
| 8. | Thanë | copë | 2 | 500 | 1000 lek |
| | SHUMA TOTALE | | | | **162 000** Lek |

Referenca e vlerave te pemeve është konform tabelës së përcaktimit të vlerave të dru frutorëve Tab.2

Përbërja e komisionit :

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Gjin MANDREJA | Kryetar | Adm. Nj.A Rrëshen |
| 2. | Gjon LLESHAJ | Anëtar | Topograf |
| 3. | Juljan TUSHAJ | Anëtar | Ing.Urbanistika |
| 4. | Simon DODA | Anëtar | Specialist Kadastre |
| 5. | Viktor VOKRRI | Anëtar | Specialist.EC&K |

U. Bosi Qi Marin. Gjok Vuka

Nr. 2425 Prot
Dt. 30.06.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË SEKRETARIA

Rrëshen më 29/06/2023

KËRKESË

**Drejtuar: Bashkisë Mirditë, Drejtorisë së Bujqesisë**

Unë i nënshkruari Gjovalin Nikoll Gjoka, ju paraqes një ankesë të fshatarit Lodovik Syziu, pasi ky ka një ankesë drejtuar kryetarit të fshatit Malaj Qender për problemin e kanalit vaditës, ku ankesa e këtij është si më poshtë vijon:

(KENIS LOCAJ)

Mos pastrimi i kanalit dhe mos mirëmbajtja e kanalit nga punëtori më ka shkaktuar dëm në token bujqesore pasi uji ka kaluar nga kanali dhe më ka shembur token.

Ju drejtohem ju si Drejtori që t'a merrni parasysh kërkesën dhe ta zgjidhni këtë konflikt.

Bashkë me ketë kërkesë po ju bashkangjes edhe kërkesën e bashkëfshatarit.

**Me respekt**

**Kryetari i fshatit Malaj – Qender**

**Gjovalin Gjoka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN BASHKIA MIRDITË KRYETARI I FSHATIT MALAJ

- Elli Prenga
- Gjon Lleshaj
2P. 06. 2023

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

# ÇERTIFIKATË 1681031

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit MIRDITE Zona Kadastrale Nr. 2552

Numri i Pasurisë 85/3 Volumi 3 Faqe 112

Adresa e Pasurisë MALAJ QENDER MIRDITE

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 950 m2

Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

## KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| RENIS | LLESH | LOCAJ | 1 | MALAJ QENDER |
| - | - | - | - | - |

- është pronar i -
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi ...ri. 85/3
- kufizimet e pasurisë janë : V 85/2, L 66, J 67, P 67

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 27.3.2017 Nr. 813

Data e lëshimit të çertifikatës

03-05-2017

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI